

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ/UROŠEVAC

P. nr. 250/13

6 tetor 2016

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ/UROŠEVAC, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk, si Kryetar i trupit gjykues, Gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma dhe Gjyqtari vendor Musa Konxheli si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Hysni Recica, në rastin penal kundër:

Nofka	M.
Emri i babait	X
Data e lindjes	X
Vendlindja	X
Gjinia	Mashkull
Adresa	XX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Profesioni	XX
Nr. personal	XX
Gjendja financiare	XX
Statusi familjar	XX

Shkollimi	XX
I arrestuar	XX
Masat kufizuese	XXX

Dhe

2. V.T.

Nofka	-
Emri i babait	X
Data e lindjes	X
Vendlindja	X
Gjinia	Mashkull
Adresa	X
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Profesioni	X
Nr. personal	X
Gjendja financiare	X
Statusi familjar	X
Shkollimi	X
I arrestuar	X

I akuzuar nga Prokurori i EULEX-it në Aktakuzën PPS Nr. 05/2012, parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj/Uroševac me 27 dhjetor 2013, me veprat penale si në vijim:

M.S. (dhe B.SH.):

PIKA 1: SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 339, paragrafi 2, në lidhshmëri me paragrafin 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 422 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

PIKA 2: MARRJA E RRYSHFETIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 343, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 428 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

PIKA 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 345, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 431, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

M.S. dhe V.T.

PIKA 4: SHMANGIA NGA PAGESA E TARIFAVE TË DETYRUSHEME DOGANORE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

M.S. dhe V.T.

PIKA 5: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE, në shkelje të Nenit 388, paragrafi 1, i KPK-së 2013.

M.S. (dhe R.A.):

PIKA 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE, në shkelje të Nenit 388, paragrafët 1 dhe 2, të KPK-së 2013.

M.S.

PIKA 7: MOSLAJMËRIMI VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në shkelje të Nenit 386, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9, i KPK-së 2013.

PIKA8: MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, në shkelje të Nenit 374 paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 120, pika 38, e KPK-së 2013.

Duke vendosur në bazë të Neneve 248, 326, 357, 359, 360, 361, 362, 365 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale (“KPP”; Ligji Nr. 04/L-123) dhe pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore në Gjykatën Themelore në Ferizaj/Uroševac pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore në Gjykatën Themelore në Ferizaj/Uroševac (mbajtur në Kacaniku/Kacanik dhe Prishtinë/Priština) me 19 dhe 30 maj, 2 dhe 12 qershor, 10 dhe 11 korrik, 4 dhe 25 gusht, 8, 16, 19 dhe 30 shtator, 13 dhe 28 tetor, 13, 14 dhe 27 nëntor, 5, 8 dhe 15 dhjetor 2014, 16, 26 dhe 30 janar, 10, 23, 24, 25 dhe 26 shkurt, 31 mars, 21, 23, 27, 28, 29 prill, 13, 15, 19, 27 maj, 22 dhe 29 qershor, 1, 2, 3, 9, 10, 13, 14, 16, 21, 22, 23, 24 korrik, 2 dhe 29 shtator, 13, 19, 27, 28 tetor, 16, 20, 23, 24 nëntor, 7, 8 dhe 17 dhjetor 2015, 15 shkurt, 17, 18, 21 dhe 24 mars, 22 dhe 25 dhe 26 prill, 22 qershor, 21 korrik, 5, 9, 26 dhe 30 shtator 2016 dhe 4 dhe 6 tetor 2016 në prani të Prokurorit të PSRK-së, Drew G. Engel dhe të pandehurve; M.S. dhe V.T. dhe avokatëve të tyre mbrojtës, A.I., dhe A.R.(për M.S.) dhe A.S.

(për V.T.) përkatësisht dhe në të cilën palët e dëmtuara ishin ose të pranishme ose të ftuar të gjithë;

Trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe votimit në bazë të Nenit 357.2, Nenit 359 dhe Nenit 364.3 të Kodit të Procedurës Penale (“KPP”), në seancë të hapur dhe në prani të palëve, lëshon dhe shpall si në vijim:

AKTGJYKIM

I pandehuri, M.S. me të dhëna personale si më lartë, është gjetur **FAJTOR**, për;

M.S. (dhe B.SH.):

PIKA 1: SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 339, paragrafi 2, në lidhshmëri me paragrafin 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 422 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse, në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose diku tjetër në Kosovë, të pandehurit **M.S.**, si një person zyrtar, d.m.th. toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i njësisë së Anti-Trafikimit në Ferizaj dhe **B.SH.**, si një person zyrtar, d.m.th. një zyrtar policor, në bashkëkryerje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, përkatësisht ata kanë marrë para nga Xh.B. dhe A.S. dhe nga anëtarët e tjerë të familjes B.S. (përkatësisht, 4750 Euro), duke u

shkaktuar me këtë dëme financiare këtyre individëve, në këmbim të premtimit për ta siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, ose duke premtuar që ata do sigurojnë që ai të mos dënohet dhe/ose premtimin që ata do sigurojnë që ai të mos e vuajë dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve kanë përfshirë, përpos tjerash, duke i thënë familjes S. se të pandehurit do të i kontaktojnë dëshmitarët në mënyrë që ata të i ndryshojnë deklaratat e tyre kundër Bidajetit, do u japin dhurata prokurorëve të caktuar për rastin e Bidajet-it, dhe do të mbajnë dëshmi të caktuara kundër Bidajetit nga shkresat e lëndës të dorëzuara në zyrën e prokurorit.

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur **FAJTOR**, për;

PIKA 2: MARRJA E RRYSHFETIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 343, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së.

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose vende të tjera në Kosovë, të pandehurit **M.S.**, si person zyrtar, pra, një toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i Njesisë së Anti-Trafikimit në Ferizaj dhe **B.SH.**, si një person zyrtar, përkatësisht një zyrtar policie, në bashkëkryerje kanë kërkuar dhe pranuar dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për vete (domethënë, pagesë monetare që arrin në rreth 4750 Euro) për të kryer në kuadër të autoritetit të tyre një akt apo veprim zyrtar apo tjetër të cilën ata është dashur apo kanë mundur që ta kryejnë, në mënyrë që ose ta siguronin lirimin e B. S. nga paraburgimi, ose që të siguronin që ai të mos dënohej dhe/ose të siguronin që ai të mos e vuajë dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve përfshijnë, ndër të tjera, duke i thënë familjes Sylejmani se të pandehurit do të i kontaktojnë dëshmitarët që ata të i ndryshojnë deklaratat e tyre kundër

Bidajetit, do u japin dhurata prokurorëve të caktuar për rastin e B.-it, dhe do të mbajnë dëshmi të caktuara kundër B. nga shkresat e lëndës të dorëzuara në zyrën e prokurorit.

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur **FAJTOR**, për;

PIKA 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 345, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 431, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose vende të tjera në Kosovë, të pandehurit M.S. dhe B.SH., në bashkëkryerje, kanë kërkuar dhe kanë marrë një ofertë (domethënë, pagesë monetare që arrin në rreth 4750 Euro) të një avantazhi të parregullt për vete në këmbim të një ushtrimi të një ndikimi të papërshtatshëm nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e personit zyrtar në mënyrë për të siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, ose të sigurojnë që ai nuk do të dënohet dhe/ose do siguronin që ai nuk do e vuante dënimin e tij, pa marrë parasysh nëse ndikimi është ushtruar ose nëse ndikimi i supozuar shpie në rezultatin e synuar.

M.S. (dhe V.T.):

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur

JO FAJTOR për;

PIKA 4: SHMANGIA NGA PAGESA E TARIFAVE TË DETYRUSHEME DOGANORE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse V.T. qëllimisht ka shmangur pagesën e tarifës së tatimit doganor ose tarifave të tjera ose detyrimeve tjera doganore për pagesën e importimit të mallrave përkatësisht, një automjet duke qenë një Renault Clio, me tabela regjistrimi të Francës CC-590-DN, duke përfshirë edhe kërkimin e intervenimit të të pandehurit M.S. kur V.T. qe ndalur nga një zyrtar policor me datë 28 maj 2013, për të shmangur pagesën e tarifave doganore apo obligimeve të tjera që i nënshtrohen pagimit, ose duke e konfiskuar automjetin e lartpërmendur. M.S. pastaj ka intervenuar në mënyrë që të sigurojë që V.T. ta marrë një “dënim simbolik”, dhe në këtë mënyrë qëllimisht ia ka mundësuar V.T.t që të shmangi pagesën e tarifave doganore, tarifave tjera apo detyrimeve doganore për pagesën e automjetit të sipërpërmendur. Duke vepruar në këtë mënyrë, M.S. po ashtu ia ka mundësuar V.T.t konfiskimin e mallit, përkatësisht të automjetit të sipërpërmendur, që nuk qe deklaruar siq do duhej apo pagesën e vlerës.

M.S.:

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur

JO FAJTOR për;

PIKA 5: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE, në shkelje të Nenit 388, paragrafi 1, i KPK-së 2013.

Sepse me datë 28 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë ose diku tjetër në Kosovë, i pandehuri **M.S.** qe informuar me telefon nga një person i quajtur **V.T.** se ky i fundit qe ndaluar në rrugë nga policia për shkak se ai ishte duke e vozitur një automjet të paregjistruar dhe se nuk e kishte paguar doganën për atë makinë, specifikisht për makinën Renault Clio, me tabela regjistrimi të Francës CC-590-DN. Me kërkesë të **V.T.**, **M.S.** foli me zyrtarin policor që e kishte ndaluar **T.** dhe e ka bindur këtë zyrtar policor që vetëm të ia lëshoj atij një dënim për kundërvajtje. Duke vepruar në këtë mënyrë, **M.S.** e ka ndihmuar **V.T.** si autor i një veprë penale (do të thotë, shmangja e pagesës së tarifave të detyrueshme doganore, në kundërshtim të Nenit 318 paragrafi 1 i **KPK-së**) ti shmanget zbulimit ose arrestimit.

I pandehuri, **M.S.** më të dhëna personale si më lartë, është gjetur **FAJTOR**, për;

PIKA 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE, në shkelje të Nenit 388, paragrafët 1 dhe 2, të KPK-së 2013.

Sepse me datë 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë apo diku tjetër në Kosovë, I pandehuri **M.S.** qe informuar se **R.A.** kishte gjuajtur në një makinë afër një restorani të quajtur “ International”. Jo vetëm që **M.S.** nuk e raportoi këtë incident, ai në mënyrë aktive ka ndërhyrë që ti bind viktimat që të mos e raportojnë incidentin që ka përfshirë **R.A.**, në polici. Duke vepruar në këtë mënyrë, **M.S.** e ka ndihmuar **R.A.** si një kryes i veprës penale (do të thotë, në shkelje të Nenit 365(1) “Shkaktimi i rrezikut të Përgjithshëm” dhe Nenit 375(2) “Përdorimi i një arme apo instrumenti të rrezikshëm” të **KPK-së** 2013, të cilat janë vepra penale nën Kapitullin XXX –Veprat Penale me Armë të **KPK-së** 2013) në shmangien e zbulimit ose arrestimit dhe ndërmori

veprime për pengimin e arrestimit, ekzekutimin ose dënimin e R.A. duke siguruar që R.A. të mos raportohej për veprën penale që e ka kryer.

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur **FAJTOR**, për;

PIKA 7: MOSLAJMËRIMI VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në shkelje të Nenit 386, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9, i KPK-së 2013.

Sepse me datë 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë ose diku tjetër në Kosovë, i pandehuri **M.S.** qe informuar se **R.A.** kishte gjuajtur në një makinë në afërsi të një restorani të quajtur “International”. M.S. më pas nuk e raportoi këtë incident, që përbën një vepër penale (do të thotë, shkelje të Nenit 365(1) “Shkaktimi i rrezikut të Përgjithshëm” dhe Nenit 375(2) “Përdorimi i armës apo i një instrumenti të rrezikshëm” të KPK-së 2013, të cilat që të dyja janë vepra penale nga Kapitulli XXX –Veprat Penale me Armë të KPK-së 2013).

I pandehuri, M.S. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur **JO FAJTOR**, për;

PIKA 8: MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, në shkelje të Nenit 374 paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 120, pika 38, e KPK-së 2013.

Sepse me 11 shtator 2013, në Ferizaj, Kosovë, **M.S.** ka pasur në pronësi, kontroll ose posedim një sasi prej 48 plumba të municionit të mprehtë, duke mos e pasur në posedim licencën e kërkuar me ligj; dhe ka pasur në pronësi, kontroll apo posedim

një sasi prej 50 plumba “gazi”, të ndaluara me Ligjin për Armët në Nenin 4, paragrafi 1.1.10, duke shkelur Ligjin e zbatueshëm (Ligji mbi Armët).

I pandehuri, V.T. më të dhëna personale si më lartë, është gjetur

JO FAJTOR për;

V.T. dhe (M.S.):

PIKA 4: SHMANGIA NGA PAGESA E TARIFAVE TË DETYRUSHEME DOGANORE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse **V.T.** qëllimisht ka shmangur pagesën e tarifës së tatimit doganor ose tarifave të tjera ose detyrimeve tjera doganore për pagesën e importimit të mallrave përkatësisht, një automjet duke qenë një Renault Clio, me tabela regjistrimi të Francës CC-590-DN, duke përfshirë edhe kërkimin e intervenimit të të pandehurit **M.S.** kur V.T. qe ndalur nga një zyrtar policor me datë 28 maj 2013, për të shmangur pagesën e tarifave doganore apo obligimeve të tjera që i nënshtrohen pagimit, ose duke e konfiskuar automjetin e lartpërmendur. **M.S.** pastaj ka intervenuar në mënyrë që të sigurojë që V.T. ta marrë një “dënim simbolik”, dhe në këtë mënyrë qëllimisht *ia ka mundësuar* V.T. që të shmangi pagesën e tarifave doganore, tarifave tjera apo detyrimeve doganore për pagesën e automjetit të sipërpërmendur. Duke vepruar në këtë mënyrë, **M.S.** po ashtu *ia ka mundësuar* V.T.t konfiskimin e mallit, përkatësisht të automjetit të sipërpërmendur, që nuk qe deklaruar siq do duhej apo pagesën e vlerës.

Trupi gjykues i ka dëgjuar parashtrësas nga prokurori dhe një lutje për zbutje të dënimit nga avokati mbrojtës dhe tani cakton si në vijim:

DËNIMET

M.S. (dhe B.SH.):

PIKA 1: SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 339, paragrafi 2, në lidhshmëri me paragrafin 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 422 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Trupi gjykues shqipton dënim me tre vjet burgim.

PIKA 2: MARRJA E RRYSHFETIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 343, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së.

Trupi gjykues shqipton dënimin me pesë vjet burg.

PIKA 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkë-kryerje, në shkelje të Nenit 345, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 431, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Trupi gjykues shqipton dënimin me dy vite burgim.

PIKA 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE, në shkelje të Nenit 388, paragrafët 1 dhe 2, të KPK-së 2013.

Trupi gjykues e shqipton dënimin me një vit burgim.

PIKA 7: MOSLAJMËRIMI VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në shkelje të Nenit 386, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9, i KPK-së 2013.

Trupi gjykues e shqipton dënimin me një vit burgim.

Në bazë të nenit 80.1 të KPRK-së Gjykata cakton një dënim unik prej shtatë (7) vite burgim.

Sidoqftë, në bazë të Nenit 83.1 të KPK-së, të pandehurit i është zbritur koha e kaluar në paraburgim e cila është llogaritur si në vijim:

Me 11 shtator 2013 i pandehuri është arrestuar dhe është privuar nga liria. Me 12 shtator 2013 i pandehuri është vendosur në paraburgim. Me datë 28 prill 2015 i pandehuri është lëshuar në arrest shtëpiak. Kryetari i trupit gjykues nuk e ka ndryshuar këtë masë deri më sot, kështu që i pandehuri ka kaluar një total prej 1,121 ditësh në paraburgim ose në arrest shtëpiak.

Në bazë të Nenit 42, paragrafi 1 dhe 65 paragrafi 1 KPRK, i pandehuri M.S. është përjashtuar nga mbajtja e një pozite zyrtare për një periudhë prej pesë vitesh.

Në bazë të Neneve 41.1.3, 62.2.2, 64.1 dhe 2 të KPRK-së trupi gjykues e urdhëron të pandehurin M.S. që të ia kthejë familjes S. humbjen në shumën prej 4,750€ e cila është prokuruar në mënyrë të paligjshme prej tyre nga ana e të pandehurve M.S. dhe B.SH. duke ndikuar në procedurat penale kundër B.S. I pandehuri është

së bashku dhe veçmas përgjegjës me të bashkë-akuzuarin B.SH., i cili po ashtu është deklaruar fajtor, për kthimin e kësaj shumë. E tërë shuma duhet që të kthehet gjer më datë 31 dhjetor 2020. Nëse nuk kthehet, Prokurori mund ti ri-hyjë çështjes para trupit gjykues, ose cilido anëtar të tij për ta konsideruar një dënim alternativ.

I pandehuri M.S. *mund* të jetë gjithashtu përgjegjës për anëtarët e familjes S. për dëmin ekonomik dhe personal që ata e kanë pësuar si rezultat i veprimeve të tija. Familja S. kanë paraqitur padi pranë gjykatës në këtë drejtim. Sidoqftë, këto padi do të ju nënshtrohen procedurave të ndara civile ku dëmi i pretenduar duhet të veçohet në hollësi.

Në bazë të Nenit 450 të KPP-së, shpenzimet e procedurës do të reimburohen nga i pandehuri. Këto janë vlerësuar në shumën e 500€.

Çdo kërkesë pronësore juridike do të ndiqet përmes gjykatave civile .

Aktgjykimi i arsyetuar në tërësi do të dorëzohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ/UROŠEVAC

PKR. nr. 194/15

Me datë 6 tetor 2016

Piotr Bojarczuk

Kryetar i trupit gjykues

Marie Tuma

Anëtare e trupit gjykues

Musa Konxheli

Anëtar i trupit gjykues

Hysni Recica

Procesmbajtëse

Këshillë ligjore:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj/Uroševac në Gjykatën e Apelit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kopja e aktgjykimit të plotë të arsyetuar është dorëzuar, në pajtim me Nenin 380.1 të KPP-së.